

**ALVIN SARAÇI**

**ROLI NDËRMJETËSUES I TREGTARËVE NGA SHQIPËRIA  
E JUGUT SI FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR TREGTINË  
VENECIANE**

**Abstrakt:**

*Tregtia pati një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik, demografinë dhe urbanizimin e qyteteve shqiptare. Ndërmjetësimi në tregti kishte një rëndësi të veçantë për venecianët. Një rol parësor për zgjerimin e saj luajtën tregtarët e besimit ortodoks nga Janina, Arta, Pogoni, Voskopoja etj., të cilët u vendosën në Venecia pranë vëllazërisë Scuola dei Greci nga fundi i shek. XV dhe mesi i shek. XVI. Nga këto qytete, tregtarët shqiptarë formuan disa ngulime në Bullgari, ndër të cilat Arvanitochori i Tarnovos dhe Arbanasi i Razgradit, nga ku emigruan në principatat rumune dhe arritën postet më të larta me Vasil Lup dhe Stefan Koçin, Gjergj dhe Gregor I Gjika, paraardhësit e Dora d'Istrias, Gjergj dhe Konstantin Dukën etj., të cilët kishin raporte tregtare me Venecien me anë të korrespondentëve tregtarë. Edhe dragomanët shqiptarë, si Bartolomeo Bruti dhe nipat e tij që i përkisnin familjes Boriçi (Borisi), patën një peshë të madhe në raportet e Venecies me Stambollin dhe principatat rumune. Pas hapjes së konsullatës veneciane dhe konsullatave të tjera të huaja në Durrës në çerekun e parë të shek. XVII, ku konvergonte tregtia ndërballkanike, disa nga këta tregtarë u vendosën në këtë qytet e mbajtën poste drejtuese pranë konsullatave dhe më pas një pjesë prej tyre e vazhduan tregtinë nga Venecia si tregtarë porositës (commissionari).*

**Fjalë kyçe:**

Tregtia, Venecia, Shqipëria e Jugut, Janina, Pogoni, vëllazëria Scuola dei Greci, principatat rumune.

**Ndikimi i tregtisë në urbanizimin e qyteteve**

Në shek. XVII-XVIII, shkëmbimet tregtare njohën një zgjerim të vazhdueshëm që do të reflektohej në ndryshime ekonomike dhe sociale, të cilat përbënin bazën e zhvillimit ekonomik dhe urbanizimit të qyteteve

shqiptare. Prania e një shtrese tregtare dhe artizane që i shtohet radhëve të saj ishte e dukshme jo vetëm në qytetet e mëdha shqiptare me një transformim të vazhdueshëm tashmë në qendra ekonomike, por edhe në qyteza dhe zona rurale malore. Me anë të një rrjeti tregtar, tregtarët krijuan një treg ndërterritorial dhe mundën të lidhnin edhe lokalitetet më të largëta duke i orientuar drejt tregtisë së jashtme dhe kontribuuan nga ana tjetër edhe në shpërndarjen e mallrave të huaj industrialë. Roli i tyre ndërmjetësues në hapësirën shqiptare dhe atë ndërballkanike me Venecien që në shek. XVI, ndikoi në rritjen e ekonomisë. Zonat nga vinin tregtarët, shumica prej të cilëve tregtonin me Venecien nëpërmjet Durrësit, Shkodrës dhe Vlorës ishin: Trikalla (pranë Selanikut në Tesali, Greqi), Janina, Arta, Kosturi, Saçishta Pogoni, Voskopoja, Gjirokastra, Berati, Përmeti, Tepelena dhe Këlcyra në Shqipërinë e Jugut dhe të Poshtme; Elbasani, Tirana, Durrësi, Kavaja dhe Kruja në Shqipërinë e Mesme; Shkodra, Tivari, Ulqini dhe Podgorica në Shqipërinë e Veriut; Prizreni, Gjakova e Peja në Kosovë dhe Shkupi, Struga, Ohri dhe Manastiri në Maqedoni.<sup>1</sup>

Rëndësia që i kushtuan tregut ballkanik dhe atij shqiptar shtetet europiane dhe vlerësimi i mallrave të eksportit të Perandorisë Osmane, e cila me anë të kapitulacioneve dhe marrëveshjeve tregtare u dha atyre mundësi që të ngrinin konsullata dhe të kishin privilegje tregtare që në çerekun e fundit të shek. XVII, do t'i jepte një impuls të fuqishëm tregtisë duke krijuar një bashkëveprim ndërmjet konsullatave dhe komuniteteve tregtare.

Nga fundi i shek. XVIII, duket qartë ndikimi i tregtisë mbi demografinë e qyteteve, megjithëse ai nuk do të ishte kudo i njëtrajtshëm. Le të marrim shembullin e Durrësit, seli e konsullatës veneciane e ngritur më 1671 dhe e konsullatave të tjera të huaja, dhe Shkodrës, seli e nënkonsullatës veneciane e vitit 1706. Durrësi megjithëse seli e konsullatës ishte vetëm një port tranzit për kalimin e mallrave drejt

<sup>1</sup> Traian Stoianovich, "The conquering Orthodox Merchants", në *The Journal of Economic History*, vol. XX, nr. 2, Cambridge: Cambridge University Press, 1960, f. 277; Stavri Naçi, "Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës në shekullin XVIII", në *Buletini i Shkencave Shoqërore të Universitetit të Tiranës*, 1, Tiranë: 1963, f. 14. Kjo dëshmohet në dokumentet e konsullatës veneciane të Durrësit dhe të nënkonsullatës veneciane të Shkodrës.

Venecies.<sup>2</sup> Terreni moçalor ishte një disavantazh për urbanizimin e qytetit. Duke mos qenë qendër administrative, ishte në varësi të sanxhakut të Elbasanit. Deri më 1710, kur u zgjodh nga sanxhakbeu i Elbasanit një “vojvodë”, rolin e të cilit e luante “kapiteni” i Durrësit, Durrësi varej nga autoriteti lokal i kadiut, i cili së bashku me eminin e kishin vendbanimin në Kavajë, ndërsa në Durrës e kishin rezidencën kështjellari dhe kryeartiljeri (topçibashi) i kalasë.<sup>3</sup> Në vitin 1641, sipas argjipeshkvit të Durrësit Mark Skura, qyteti numëronte 300 shtëpi brenda mureve dhe 2 000 shtëpi me gjithë provincën përreth, ndërsa sipas Jireçekut dhe Hekarit qyteti kishte 200 shtëpi, ndërsa në vitin 1670 sipas Çelebiut numri i tyre ishte reduktuar në rreth 150 shtëpi.<sup>4</sup> Që në qershor 1705, konsulli venecian Giorgio Emmanuele Cumano vërente se në Durrës po vendoseshin tregtarë nga qytetet përreth.<sup>5</sup> Por nga fundi i shek. XVIII, konsulli i Përgjithshëm francez në Janinë François Ch. H. L. Pouqueville shkruan lidhur me ndryshimet në demografinë e qytetit të

<sup>2</sup> *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*, përgatiti për botim Zija Shkodra, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, hyrje, f. 9.

<sup>3</sup> *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: Asv), Cinque Savi alla Mercanzia (më tej: CSM), 1 Serie (më tej: S), busta (më tej: b.) 661, 23 tetor 1710. “*il Pascia di Terra Nova, al quale vi è sotto-posta anco Durazzo, ha eletto un Vaivoda, che lui risieda in questa Citta' cosa non praticata, e per tale officio ha' scielto il Capitan della medesima*” (Pashai i Elbasanit, nën juridiksionin e të cilit është edhe Durrësi, ka zgjedhur një vojvodë me vendbanim në këtë qytet, gjë që nuk kishte ndodhur më parë dhe për një post të tillë ka zgjedhur Kapitenin e qytetit). *Po aty*, dok. nr. 48, f. 101-102; dok. nr. 63, 29 korrik 1705, f. 122-123 dhe dok. nr. 94, 5 shkurt 1706, f. 176. Titulli “kapiten” ekzistonte që nga periudha anzhuine.

<sup>4</sup> “III Visitationsbericht Marco Scura, Erzbischof von Durazzo, 1641”, në *Albania Sacra: Geistliche Visitationsbericht aus Albanien. 2: Erzdiözese Durazzo*, përgatiti për botim Peter Bartl, Wiesbaden: Harrassowitz Verlag, 2011, f. 112; Konstantin Jireçek, “Pozicioni dhe e kaluara e qytetit të Durrësit në Shqipëri”, në *Nga Shkodra deri në Vlorë nëpër Shqipërinë mesjetare. Kontribute për gjeografinë historike dhe mesjetën shqiptare*, përktheu nga origjinali dhe përgatiti për botim Edmond Malaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2017, f. 96; Hyacynthe Hecquard, *Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*, Tiranë: Plejad, 2008, f. 263.

<sup>5</sup> Asv, CSM, 1. S., b. 661, 3 qershor 1703; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*..., dok. nr. 36, f. 110, 3 qershor 1705.

Durrësit, se tashmë këtu kishte 5 400 familje ose një popullatë prej 27 000 banorësh.<sup>6</sup>

Zhvillimi i tregtisë pati ndikim në mënyrë të dukshme mbi urbanizimin dhe rritjen demografike të qytetit të Shkodrës, që nga 5 700 banorë në fillim të shek. XVIII, arriti numrin e 40 000 banorëve nga fundi i tij.<sup>7</sup> Kjo, sepse Shkodra ishte qendër administrative dhe tregtare së pari e sanxhakut të Shkodrës dhe pas zgjerimit të pashallëkut të Shkodrës në vitet 1757-1830, me shtrirje në Shqipërinë Veriqendrore, që përfshinte pjesë të Kosovës dhe Maqedonisë dhe portin e Durrësit, që i kishte kaluar pashallëkut të Beratit për një periudhë të shkurtër kohore.

### **Roli ndërmjetësues i dragomanëve**

Tregtia veneciane zhvillohej nëpërmjet diplomacisë ekonomike dhe konsullatave. Në këtë mes luanin një rol thelbësor diplomatët, dragomanët dhe korrespondentët tregtarë që vepronin në hapësirën ndërmjet Venecies dhe vendeve me të cilat kishte raporte tregtare.<sup>8</sup> Të njëjtën rrugë ndoqën më pas edhe vendet e tjera europiane. U ngritën një sërë konsullatash në qytetet më të rëndësishme turke dhe greke të Ballkanit.<sup>9</sup> Menjëherë pas tyre, i erdhi radha Shqipërisë dhe porteve të saj

<sup>6</sup> François Charles Hugues Laurent Pouqueville, *Voyage dans la Grèce*, vol. I, Paris: Firmin Didot, 1820, f. 400. Ky libër i shkruar në vitin 1801, u referohet viteve në kapërcyell ndërmjet fundit të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX, para se Pouqueville të bëhej konsull francez i Janinës gjatë viteve 1806-1815.

<sup>7</sup> Peter Bartl, "Notizie universali dello stato di Albania, e dell'operato da Monsig.r Vincenzo Zmaievich, Arcivescovo di Antivari, Visitatore Apostolico dell'Albania", në *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17 und 18 Jahrhundert. Albanische Forschungen*, vol. 2, München: Trofenik, 1979; Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1984, f. 184; Peter Bartl, *Shqiptarët nga Mesjeta deri në ditët tona*, përkthim i Afrim Koçit, Tiranë: IDK, 2017, f. 302; Bruce McGowan, "The Age of the Ayans, 1699-1812", në *An economic and social history of the Ottoman Empire 1600-1914*, vol. 2, përgatiti për botim Halil Inalcik, Donald Quataert, Cambridge: Cambridge University Press, 1994, f. 653.

<sup>8</sup> Stefan Ortega, *Negotiating transcultural relations in the Early Modern Mediterranean, Ottoman Venetian encounters*, New York, London: Routledge, Taylor & Francis group, 2016, f. 35-36.

<sup>9</sup> Halil Inalcik, *An economic and social history of the Ottoman Empire. 1600-1914*, vol. I, Cambridge: Cambridge University Press, 2003, f. 366-370, f. 383-384.

që do të shërbenin si vendkalim për mallrat.<sup>10</sup> Si rrjedhojë, kjo e favorizoi tregtinë sepse ajo u bë më e organizuar dhe e drejtpërdrejtë me vende në duart e të cilave ishte tregtia ndërkombëtare e distancave të largëta.

Venecia kishte nevojë për figura që të ndërmjetësonin në të gjitha nivelet. E gjendur në kufijtë sociokulturorë, përveçse atyre tokësorë dhe detarë me Venecien, shqiptarët që kishin njohuri të mira të dy kulturave, ishin të prirur që të kishin një rol ndërmjetësues.

Dragomanët nuk ishin thjesht përkthyes të diplomatëve, por të dërguar diplomatikë dhe kishin shumë peshë në marrëdhëniet dypalëshe.<sup>11</sup> Ata shërbenin në nivele të larta edhe pranë konsullatave të huaja në Stamboll në takimet diplomatike ndërmjet vezirit të Perandorisë Osmane dhe vendeve europiane. Kështu, edhe ambasada veneciane në Stamboll kishte një kryedragoman “*Gran Dragomanno*” dhe disa dragomanë. Në këtë kontekst, disa familje fisnike shqiptare si Bruti, Boriçi etj., ndoqën prej brezash karrierën e dragomanit dhe krijuan lidhje martesore mes tyre.<sup>12</sup> Ata i dërguan fëmijët e tyre në shkollën e gjuhëve

---

<sup>10</sup> Alvin Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt XVII dhe XVIII*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2018, f. 154-158.

<sup>11</sup> Ella Natalie Rothman, “Dragoman”, në *Routledge Encyclopedia of Interpreting Studies*, ed. Franz Pöchhacker, Nadja Grbić, Peter Mead, Robin Setton, London, New York: Routledge, Taylor & Francis group, 2015, f. 119.

<sup>12</sup> Noel Malcolm, *Agjentë perandorakë: një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë*, Tiranë: Dudaj, 2016, f. 25-27, 67-71, 197, 201, 208; Edmond Malaj, “Familja fisnike Bruti nga Durrësi”, në *Studime historike*, nr. 3-4, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2015, f. 26-27, 36. Familja Bruti është shquar për një plejadë njerëzish që kanë shërbyer në marrëdhëniet diplomatike, në ushtrinë veneciane dhe në hierarkinë kishtarë. Malkolm mendon se është një mbiemër i latinizuar nga Durrësi dhe nuk beson ta ketë origjinën italiane ose romake. Familja ishte pjesë e parisë së Durrësit që në shek. XIII dhe më pas u bë pjesë e administratës venedikase me Bartolomeo Brutin në postin e zëvendësrektorit të qytetit. Brutët kishin lidhje martesore me familjet fisnike më të rëndësishme shqiptare. Gjatë periudhës venedikase, një nga paraardhësit e familjes Bartolomeo Bruti, ishte zëvendësrektor i venedikas i Durrësit, por pas rënies së qytetit në duart e turqve më 1501, familja u largua në Lezhë dhe pas vitit 1506 në Ulqin. Nga mesi i shek. XVI, Antonio Bruti merrej me tregtinë e drithit mes Shqipërisë dhe Venedikut dhe luante rolin e diplomatit dhe ndërmjetësit për venedikasit për rikthimin dhe zhdëmtimin e anijeve tregtare dhe ndaljen e sulmeve nga piratët osmanë. Por ajo që na intereson është se ai ishte paraardhës i brezit të dragomanëve, që niste me djemtë e tij Bartolomeo dhe Cristoforo Bruti. Pas rënies së Ulqinit dhe Tivarit në vitin 1571, vëllai i tyre Jakomo ose Jakopo Bruti u vendos në Kapodistrian venedike (Koper, Slloveni), ndërsa, motra

(*scuola dei giovani di lingua*) ku përgatiteshin dragomanët e bailiut venecian për marrëdhëniet diplomatike të Venecies me Perandorinë Osmane.<sup>13</sup>

Kështu, më 1599 kryedragomani me origjinë shqiptare nga Tivari Marc'Antonio Borisi (Mark Anton Boriçi), i cili, jo vetëm e përktheu letrën e vezirit të rizgjedhur Ibrahim Pasha drejtuar autoriteteve veneciane, por ua rekomandoi atyre për qëndrimin e tij në favor të venecianëve dhe angazhimin në çështjet që bailiu venecian i parashtronte për t'i zgjidhur.<sup>14</sup> Madje, ai shtonte se i mbështet venecianët deri në atë pikë sa të veprojnë me autoritetin e tij nëse do të bëhen shkelje: «*Se da parte turca fossero fatti dei torti, se ne dia avviso che i responsabili saranno puniti*». Në fakt, marrëdhëniet ndërmjet personaliteteve të larta veneciane dhe osmane ishin të mira. Kjo reflektohej në respektimin e ndërsjellë të kapitulacioneve dhe marrëveshjeve dypalëshe, dhënien e privilegjeve tregtare dhe një qëndrim protektiv për tregtinë veneciane nga ana e autoriteteve osmane.

Për t'u bërë dragoman nganjëherë mjaftonte edhe njohja e gjuhëve si në rastin e Michele Cernovichio, i cili u zgjodh nga bailiu Marino Cavalli në vitin 1559 sepse njihje gjuhën turke, sllave, shqiptare, arabe dhe pak atë persiane dhe gjithashtu jepte mësim në shkollën e aspirant-dragomanëve të bailiut në Stamboll.<sup>15</sup>

Edhe Perandoria Osmane kishte krijuar institucionin e dragomanit të Divanit. Në vitin 1661, veziri Ahmed Koprulu caktoi kryedragoman grekun Panagyotis Nikousios. Kryedragomani në fjalë, i cili kishte pasur raporte të mira me shqiptarin Gjergj Gjika, do ta ndihmonte djalin e tij Gregor I Gjika që të fitonte rivalitetin me familjen fanariote Kantakuzeno në vitin 1671 dhe të rikonfirmohej në postin e princit të Vllahisë (Rumanisë).<sup>16</sup> Në këtë ndërmarrje, do të kishte një rol qendror edhe veziri me origjinë shqiptare Koprulu nga qyteti Veles i Maqedonisë\*, ku kishte

---

e tyre Jakoma u martua me Pietro Borisi-n (Pjetër Boriçin) që i përkiste një familjeje fisnike dragomanësh nga Tivari.

<sup>13</sup> Francesca Lucchetta, "La scuola dei 'giovani di lingua' veneti nei secoli XVI e XVII", *Quaderni di Studi Arabi*, vol. 7, Istituto per l'Oriente, C. A. Nallino, 1989, f. 19.

<sup>14</sup> *Inventory of the Lettere e Scritture Turchesche in the Venetian State Archives*, përgatiti për botim Maria Pia Pedani, Alessio Bombacci, Leiden, Boston: Brill, 2010, dok. nr. 567, V: 212, 19-27 janar 1599, f. 140-141.

<sup>15</sup> F. Lucchetta, "La scuola dei 'giovani di lingua' veneti...", f. 22.

<sup>16</sup> Cristian Luca, "Il soggiorno veneziano del principe Gregorio I Ghica", në *Studi Historica Adriatica ac Danubiana*, III, N.1/2, Trieste: 2010, f. 95.

\* Që më pas mori emrin Koprulu.

jetuar më parë edhe familja Gjika dhe në të njëjtën kohë Gregor Gjika pati dhe mbështetjen e Venecies, ku kishte qëndruar në periudhën e fundit si i mërguar.<sup>17</sup> Që në vitin 1664, Gregor Gjika ishte larguar drejt Vjenës, Moravës e Bohemisë nga principata rumune e Vllahisë për shkak të luftës austro-turke, sepse kishte mbështetur austriakët.<sup>18</sup> Gjatë kësaj periudhe, Gregori mbante letërkëmbim me Senatin venecian dhe në vitin 1665 duket se ai preferonte që të strehohej dhe të gjente mbrojtje në Venecia, prandaj i kërkonte asaj shtetësinë.<sup>19</sup> Në librin e Dora d'Istrias për shqiptarët e Rumanisë dhe familjen Gjika, duke u bazuar mbi dokumentet veneciane, flitet për qëndrimin e tij në Veneto dhe se ai po lobonte me autoritetet veneciane të Senatit në mënyrë të drejtpërdrejtë që të ndërhynin pranë Portës për rizgjedhjen e tij në këtë post në vitin 1672.

Njëkohësisht, përpjekjet e tij diplomatike do të përqendroheshin edhe në Stamboll, ku ai duhej të takohej me ambasadorin venecian dhe vezirin. Për këtë, nga fundi i dhjetorit 1671, Gregori do të kalonte nga Venecia në Durrës dhe nga vendi i të parëve drejt Stambollit.<sup>20</sup>

Për Venecien, si udhëkryq i tregtisë ndërkombëtare dhe vendeve të tjera të huaja ku diplomacia dhe ekonomia ishin të pandara, dragomanët luanin gjithashtu edhe rolin e korrespondentëve për tregtinë.<sup>21</sup> Dragomanët gjendeshin edhe pranë konsullatave ose pranë kancelarive dhe autoriteteve të huaja për tregtinë që kishin raporte me jashtë. Nga zonat e kufirit ku bënte pjesë edhe Shqipëria, arrinin një pjesë e dragomanëve, që njihnin mirë disa gjuhë të huaja dhe realitetet mes dy brigjeve. Misioni i tyre kishte në fokus zgjerimin e tregtisë dhe raportet me autoritetet lokale.

### **Marrëdhëniet e tregtarëve dhe princave me origjinë shqiptare të principatave rumune me Venecien**

Venecia ishte e interesuar gjithashtu për rolin ndërmjetësues të tregtarëve të huaj, të cilët mund të ishin me vendbanim në qytetin lagunar ose tregtarë lëvizës. Të tilla ishin familjet e tregtarëve nga Janina të

---

<sup>17</sup> Elena Gjika, *Shqiptarët në Rumani: historia e princërve Gjika në shekujt XVII, XVIII, XIX*, Tiranë: Kadeli, 2015, f. 61-71.

<sup>18</sup> C. Luca, "Il soggiorno veneziano del principe Gregorio I Ghica...", f. 92-93.

<sup>19</sup> E. Gjika, *Shqiptarët në Rumani...*, f. 61-62.

<sup>20</sup> Asv, CSM, BC, Ducali, b.1, 23 prill 1672.

<sup>21</sup> E. N. Rothman, "Dragoman...", f. 120.

pranishme në Venecia që në vitin 1498 me themelimin e vëllazërisë greke *La Scuola dei Greci*. Në këtë vëllazëri bënin pjesë jo vetëm grekë, por dhe shqiptarë, arumunë (rumunë) dhe serbë të besimit ortodoks<sup>22</sup>. Pra, duke qenë se fjala “grek” përmblihte komunitete të të njëjtit besim, kjo mund të ndikonte te familjet e pasura shqiptare dhe rumune, të cilat mund të asimiloheshin nga komuniteti grek<sup>23</sup>. Shqiptarët që jetonin këtu, në fillim i përkisnin kryesisht familjeve të mëdha stratiote.<sup>24</sup> Nga mesi i shek. XVI (1563) emrat e tregtarëve nga Janina shfaqen në regjistrin ose Mariegola (Rregulla Mëmë) e vëllazërisë.<sup>25</sup> Ata njiheshin si të ashtuquajturit tregtarë epirotë<sup>26</sup> nga Janina dhe Pogoni, të cilët tregtonin kryesisht me principatat rumune.

Tregtia qe arsyeja kryesore e cila ndikoi në krijimin dhe zgjerimin e një diaspore shqiptare në shek. XVI-XVII në Ballkan dhe në ndryshimet sociale që pasuan. Kështu, bëhet fjalë për një emigrim ndërballkanik drejt verilindjes kryesisht nga Shqipëria e Jugut dhe e Poshtme dhe krijimit të rreth dhjetë ngulimeve shqiptare me emrin Arvanitokori, Arbanasi ose

<sup>22</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë (1675-1699)*, vëll. IV, përgatiti për botim Injac Zamputi, Selami Pulaha, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë: 1990, dok. nr. 228, 8 shkurt 1699, f. 478 1r (referenca 1). Këtë e pohon edhe Zamputi, i cili në shpjegimet e dokumenteve flet për shpërndarjen e komunitetit shqiptar në Venecia sipas përkatësisë fetare: të ortodoksëve pranë *Scuola dei Greci* dhe katolikëve pranë *Scuola degli Albanesi*. T. Stoianovich, *The conquering Orthodox merchants...*, f. 290-291. Greqishtja ishte jo vetëm gjuha që i përkiste kulturës ortodokse, por përdorej edhe në tregti.

<sup>23</sup> T. Stoianovich, *The conquering Orthodox merchants ...*, f. 290-291.

<sup>24</sup> Paolo Petta, *Stratitotët, ushtarë shqiptarë në Itali (shek. XV-XIX)*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë: 2006; Giorgos Plakotos, “Diasporas, space and imperial subjecthood in Early Modern Venice: A comparative Perspective”, në *Diasporas, circulations, migrations, histoire. Scènes urbaines*, Toulouse: Presse universitaire du Midi, 2016, 28, f. 52-54.

<sup>25</sup> Lidia Cotovanu, “Gestionari epirofi ai cămărilor domnești. Cazul negustorilor Igumenos de la Ioannina și al familiei lor extinse (Sfârșitul secolului al XVI-lea – începutul secolului al XVIII-lea)”, në *Dinamici sociale și transferuri culturale în Sud-Estul european (sec. XVI-XVII)*, ed. Andrei Timotin, București: 2019, f. 151.

<sup>26</sup> Për Epirin dhe Shqipërinë e Poshtme mund t'i referohemi kapitullit I, në Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVIII*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2016, f. 24-34, 43-45. Megjithatë, duke u nisur nga përkatësia toske e kësaj zone, në këtë artikull është preferuar të përdoret termi “Shqipëri e Jugut” në vend të shprehjes “Shqipëri e Poshtme”.



Arnautkoy në Bullgari\*, ku më të rëndësishmit ishin Arvanitokori pranë kryeqytetit të vjetër bullgar Tarnovo, që ishte vendbanim i tregtarëve i ngritur që në periudhën mesjetare dhe Arvanitokori ose Arbanasi i Răzgradit (Cernavoda) në Bullgarinë Veriore.<sup>27</sup> Më pas, një pjesë e tyre kryesisht tregtarë kaluan në Principatat e Rumanisë dhe Moldavisë, ku ata u vendosën nga çereku i fundit të shek. XVI dhe u bënë pjesë e administratës dhe fisnikërisë lokale.<sup>28</sup> Rugët e komunikimit ndërmjet dy vendeve kalonin në Lovea, qendër tregtare mallrash në Bullgarinë Veriore që lidhej me Vlahinë e Brashovin dhe panairin e Leipçigut.<sup>29</sup>

Një nga faktorët mund të kenë qenë lidhjet fisnore dhe marrëdhëniet e ngushta ndërmjet familjeve shqiptare, veneciane, rumune dhe greko-fanariote si dhe postet e larta që pasardhësit e tyre mbanin në principatat rumune.

Disa studiues janë përpjekur të bëjnë kërkime lidhur me origjinën e të huajve në principatat rumune nëpërmjet kancelarisë rumune dhe moldave në shek. XV-XVII. Në një kampion prej 240 emigrantësh, 141 prej tyre, pra një numër i konsiderueshëm ishin nga Gjirokastra, Delvina, Pogoni, Konica e Janina. Ndër 91 të tjerë që arrinin shumica nga Bullgaria, përmendet se disa ishin me prejardhje nga Arvanitochori i

\* Asenovgrad (Stanimaka), Rodope, Mandritsa etj.

<sup>27</sup> E. Gjika, *Shqiptarët në Rumani...*, f. 13; Lidia Cotovanu, “L’émigration sud-danubienne vers la Valachie et la Moldavie et sa géographie (XVe-XVIIIe siècles): la potentialité heusterique d’un sujet peu connu”, në *Cahiers balkaniques*, 42, 2014, f. 3-4. Arbanasi i Răzgradit pranë Varnës ishte vendbanim i tregtarëve të Janinës, ndërsa Arvanitochori i Tarnovos shërbente si vendbanim i tregtarëve të Pogonit dhe të Voskopojës. Veselin Goranchev, “About the role of the Orthodox clergy for the Greek School of the Arbanasi Village (VelikoTarnovo, Bulgaria) in the XIX Century”, në *Orthodox scientist in modern world. Values of Orthodox World and contemporary society*, (materials of the IV international conference), pjesa 2, Selanik, 25-26 shtator 2015, Athens: 2015, f. 166-167; Kostantin Jireček, *Geschichte der Bulgaren*, Prag: F. Tempsky, 1876, f. 257, 458-459.

<sup>28</sup> Cristian Luca, “Aspetti riguardanti i traffici mercantili e la circolazione del denaro tra Venezia, Costantinopoli e i Principati Romeni nei secoli XVI-XVIII”, në *L’Europa Centro-Orientale e la Penisola italiana; quattro secoli di rapporti eflussi intercorsi tra Stati e civiltà*, ed. Cristian Luca, Gianluca Masi, Venezia: Brăila, Istros editrice del Museo di Brăila, 2007, f. 255-258.

<sup>29</sup> Luigi Mascilli Migliorini, Francesca Canale Cama, Daniela Casanova, Rosa Maria Delli Quadri, *Storia del Mediterraneo moderno e contemporaneo*, Napoli: Alfredo Guida editore, 2009, f. 193-194.

Veliko Tarnovos në Bullgari.<sup>30</sup> Shumica prej tyre i përkisnin shtresës së fisnikëve, priftërinjve, tregtarëve, personelit ushtarak dhe fshatarëve.<sup>31</sup>

Megjithëse një sërë autorësh kanë shkruar për marrëdhëniet shqiptaro-rumune, emigrimin dhe komunitetet shqiptare në këto principata, nuk është arritur që të ketë një studim të mirëfilltë, por ndonjë studiues rumun e ka lidhur atë me aktet e dhurimit ose donacionet që disa princa rumunë i kishin bërë kishave të Epirit, që gjenden sot në Shqipëri dhe Greqi, të cilat nisin me vitin 1517 me princin Neagoe Besarab (1512-1521).<sup>32</sup> Në fakt, po t'i referohemi biografisë së Shën Nifonit, një patriarku të Kostandinopojës me origjinë shqiptaro-greke, shkruar nga murgu Gabriel i Malit Atos, aty flitet për princin rumun që kishte kontribuar për ndërtimin e portit të Vlorës.<sup>33</sup> Vetë Shën Nifoni, bashkëkohës i tij, ishte shuguruar prift në Durrës në epokën e Skënderbeut, të cilin e kishte njohur personalisht dhe më pas kishte qenë metropolit (ekzark) i kishës ortodokse në Vllahi në periudhën 1503-1505 gjatë sundimit të princit Radu.\* Reliket e tij që gjendeshin në altarin e manastirit Dionisiou, i ishin dhënë princit Besarab nga murgjit e Malit Atos për t'i vendosur në katedralen e re të ngritur prej tij - Curtea de Argeș.

<sup>30</sup> L. Cotovanu, "L'émigration sud-danubienne...", f. 3-6.

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 3.

<sup>32</sup> Lidia Cotovanu, "Le diocèse de Dryinoupolis et les bienfaiteurs de Valachie et de Moldavie. Solidarités de famille et traits identitaires multiples (XVIe – XVIIe siècle)", në Petronel Zahariuc, *Contribuții privitoare la istoria relațiilor dintre țările române și bisericile răsăritene în secolele XIV – XIX*, Iași Editura Universității "Alexandru Ioan Cuza": 2009, f. 219-220.

<sup>33</sup> Tudor Teoteoi, "Ascalon – A Mistaken toponym in the life of Niphon II, patriarch of Constantinople", (Mélanges offerts au XVIe Congrès International d'Études Byzantines, Vienne, tetor, 1981), në *Revue des études sud-est européennes*, vol. 19, nr. 3, Institut d'études sud-est européennes, Académie des sciences sociales et politiques, Bucarest: korrik-shtator 1981, f. 612-616; Kriton Chrysochoidis, "Aspekte të marrëdhënieve të Malit Athos dhe trevave shqiptare në periudhën pasbizantine", në *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*: aktet e simpoziumit ndërkombëtar, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Tiranë, 16-18 nëntor 2000, Tiranë: 2003, f. 61.

\* Shën Nifoni ngjiti të gjitha shkallët e hierarkisë së kishës ortodokse: u shugurua dhjak nga peshkopi i Vlorës dhe prift nga peshkopata e Durrësit që përfshinte edhe Krujën dhe në vitin 1452, u zgjodh kryepeshkop i Ohrit dhe së fundi Patriark i Kostandinopojës në periudhat 1486-1488, 1497-1498 dhe 1502. Vdiq në Malin Atos dhe reliket e tij gjenden në Târgoviște të Rumanisë.

Ekzistonin gjithashtu lidhje fisnore dhe marrëdhënie të ngushta ndërmjet princave të Vllahisë me familjet veneciane dhe të diasporës shqiptare të Perëndimit. Kështu, princi i Moldavisë Marcu Cercel kishte lidhje farefisnore me fisnikun venecian Giovanni Zane.<sup>34</sup>

Me shumë peshë duhet të ketë qenë dhe fakti se në vitin 1580, shqiptari Bartolomeo Bruti i shpëtoi jetën princit të Moldavisë Petru Şchiopul (Pjetër çalamani), nëpërmjet vezirit Sinan Pasha, me të cilin kishte lidhje farefisnore, prandaj princi rumun i cili u rikthye në periudhën 1582-1591 në Iashi, kryeqyteti i Moldavisë, i dha si shpërblim postin e *postelnikut* që i korrespondon dhomëtarit (kamerlengut), që merrej me financat e principatës, por që mund të luante edhe rolin e ministrit të Jashtëm, dhe pas tij u vendosën këtu edhe kushëri i tij Antonio Bruni dhe nipi Bernardo Borisi (Boriçi), dragoman i princit rumun në vitet 1587-1589.<sup>35</sup> Gjithashtu, Bruti pati edhe benefite të tjera, sepse atij iu dhanë të ardhurat doganore vjetore prej 3 000 dukatesh të një porti rumun dhe titulli “kapiten i Lapushnës”.<sup>36</sup>

Falë këtyre lidhjeve, më pas edhe nipat e tjerë të familjes Boriçi patën marrëdhënie me principatat rumune, ndër të cilët kryedragomani Marc’Antonio Borisi dhe vëllezërit e tij Marino Borisi, i cili në vitin 1588 merrej me tregtinë e stolive për princin Mihnea dhe ishte korrespondent tregtar i tregtarit venecian Antonio Paruta, që jetonte në

---

<sup>34</sup> Maria Pia Pedani, “I Veneziani a Costantinopoli alla fine del XVI secolo”, në *Veneziani in Levante, Mussulmani a Venezia, Quaderni di Studi Arabi, 15 supplemento*, Istituto per l’Oriente C.A., Venezia: 1997, f. 67-84, 73.

<sup>35</sup> Grigore Ureche, *Chronique de Moldavie depuis le milieu du XIVe siècle jusqu’à l’an 1594 par Grégoire Urechi*, përktheu e përgatiti për botim Émile Picot, Paris: Ernest Leroux, 1878, f. 536-537. Grigor Ureche është djali i Nestorit, një bashkëkohësi të Bartolomeo Brutit, i cili kishte jetuar në Poloni dhe kishte qenë këshilltar i princave Konstantin dhe Aleksandër Movila, që mbështeteshin nga polakët, ndërsa Grigore ishte *spathar* (titulli komandant i ushtrisë) i princit me origjinë shqiptare të Moldavisë, Vasil Koçi (Vasile Lupu Coci, 1634-1653) dhe kishte studiuar në Poloni. N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 260, 374-376; E. Malaj, “Familja fisnike Bruti...”, f. 37; Cristian Luca, “Il principe valacco Petru Cercel e Venezia. Documenti inediti (1588)”, në *Ateneo Veneto, Atti e memorie dell’Ateneo Veneto*, viti 188, vol. 39, Venezia: 2001, f. 108.

<sup>36</sup> Asv, Bailo a Costantinopoli (më tej: BC), Lettere, b. 14, 15 mars 1580, Gabriel Cavazza, sekretar i bailit Nicolo’ Barbarigo, që kishte ndërruar jetë më 1 mars 1580, dhe ishte zëvendësuar nga ambasadori i ri Paolo Contarini; N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 271.

Stamboll.<sup>37</sup> Gjithashtu, edhe vëllai tjetër aspirant-dragoman Francesco Borisi ishte financuar nga princi për të tregtuar në Moldavi dhe Kairo.<sup>38</sup> Tregtisë së stolive iu dedikua edhe vëllai i Bartolomeos, Cristoforo Bruti, ndoshta sepse i përkiste së njëjtës familje dhe kjo i jepte mundësi që të ishte në kontakt me sferat e larta të perandorisë.<sup>39</sup>

Bartolomeo dhe Cristoforo Bruti ishin bijtë e Antonios që kishte jetuar për një kohë të gjatë në Ulqin. Ata e ndihmuan tregtarin Antonio Paruta i cili ndërkohë kishte ndërmarrë edhe tregtinë e verës *malvasia* që ta zgjeronte atë nga Kreta nëpërmjet Moldavisë me qytetin asokohe polak Lwów (Lviv, Ukrainë) dhe kishin strehuar disa korrespondentë tregtarë të kompanisë në banesën e tyre moldave.<sup>40</sup>

Në fakt, roli ndërmjetësues i Brutit kishte qenë vendimtar në vitin 1573 gjatë paqes veneto-osmane për shkëmbimin e robërve të luftës dhe arritjen e paqes në negociatat polako-turke dhe për këtë në vitin 1591 atij iu dha titulli fisnik polak. Lidhur me këtë, bailiu Girolamo Lippomano shkruante:<sup>41</sup>

“Por z. Bartolomeo Bruti erdhi këtu me ambasadorin e Polonisë, i dërguar nga zotëria i tij princi i Moldavisë, i cili për ta ndalur luftën në shtëpinë e tij, është kujdesur gjithmonë që t’i sheshojë këto mosmarrveshje dhe mundi ta bindë Pashain ditën e djeshme, duke e shtyrë më në fund që të kënaqet duke konfirmuar miqësinë e mëparshme...”

Një fakt tjetër i rëndësishëm ishte se Bartolomeo Bruti kontribuoi për krijimin e një kiske ortodokse uniate në Moldavi me katolicizmin polak me anë të misionarëve jezuitë.<sup>42</sup> Sigurisht, për këtë qëllim ndërhyri në

<sup>37</sup> N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 358; C. Luca, “Aspetti riguardanti i traffici...”, f. 249-250.

<sup>38</sup> C. Luca, “Aspetti riguardanti i traffici...”, f. 257.

<sup>39</sup> N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 358.

<sup>40</sup> C. Luca, “Aspetti riguardanti i traffici...”, f. 250.

<sup>41</sup> N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 218-222; Eudoxin de Hurmuzaki, *Documente privitoare la istoria românilor*, 1600-1650, vol. 4, parte 2, București: Academiei Române, 1884, dok. CII, 22 qershor 1590, f. 152. “...*Ma il Signor Bartolomeo Brutti venuto qui con il Nontio di Pollonia mandato dal Principe di Bogdania suo padrone, che per liberarsi dalla guerra in casa propria ha procurato sempre, che queste differenze restino accomodate ha ben saputo persuadere il Bassa, che lo indusse finalmente l’atr’hieri a contentarsi di confirmare l’amicitia vecchia...*”.

<sup>42</sup> G. Ureche, *Chronique de Moldavie...*, f. 554-555.

fillim pranë vezirit që të zgjidhej në krye të Rumanisë princi protestant sakson Iancu, por më pas meqë ai nuk e paguante haraçin, u vendos zëvendësimi i tij me Petru Şchiopul.<sup>43</sup>

Rreth vitit 1590, Bernardo Borisi që ishte vendosur në Kapodistria (Koper i Sllovenisë) dhe mbante postin e kapitenit të milicëve dhe vëllai i tij kryedragomani Marc'Antonio Borisi krijuan marrëdhënie të ngushta me shtetasin venecian Giovanni Graziani nga Kapodistria, i cili pati disa funksione: dragoman i Portës, dukë i Paros dhe Naxos dhe princ i Moldavisë më 1619.<sup>44</sup> Sipas akteve të bailiut në vitet 1613-1614, tregtarët Marc'Antonio Crauta nga Zante dhe Felice Floriani nga Venecia e kishin pasur Gracianin korrespondent tregtar.<sup>45</sup>

Falë raporteve të ngushta ndërmjet autoriteteve, dragomanëve dhe komuniteteve tregtare, Bartolomeo Bruti i ishte futur edhe rrugës së tregtisë dhe kishte ngritur një kompani në ortaki me tregtarin venecian Tommaso Zanetti, e cila tregtonte peshk të thatë, havjar dhe lëkurë nga Stambolli në Venecia.<sup>46</sup>

Pikërisht, më 1583, ishte kryedoganier Sima Vorsi, një tregtar nga ishulli i Scios (Chios) që bënte pjesë në *entourage-in* e Bartolomeo Brutit dhe të dy si kreditorë kishin ndihmuar princin rumun për të kapërcyer vështirësitë financiare.<sup>47</sup> Bruti kishte marrëdhënie edhe me tregtarët raguzanë, prandaj ai i dha me koncesion doganat e Moldavisë tregtarit raguzan Domenico de Giorgi.

Megjithatë, kishte edhe tregtarë të tjerë në oborrin e Petru Şchiopul, ndër të cilët Jani Kallogjeri nga Pogoni, i cili mbante postin e Thesambajtësit dhe Zoto Cigara nga Janina, dhëndri i princit me postin e *spatarit* ose komandantit të ushtrisë.<sup>48</sup> Nga fundi i shek. XVI, Zoto

<sup>43</sup> N. Malcolm, *Agjentë perandorakë...*, f. 322.

<sup>44</sup> *Po aty*, f. 358; Nicolae Iorga, *Histoire des romains de la Péninsule des Balcons*, Bucarest: Cultura Neamului Românesc, 1919, f. 33.

<sup>45</sup> C. Luca, "Aspetti riguardanti i traffici...", f. 251.

<sup>46</sup> Cristian Luca, "Venetian merchants in the Lower Danube Area and the role in the development of the international trade exchanges in the Seventeenth Century", në *The Czech Historical Review / Český Časopis historický*, 109, nr. 2, Studies and articles / Studie a materiáli, Praha: 2011, f. 294-327, 310.

<sup>47</sup> Cristian Nicolae Apetrei, "Greek merchants in the Romanian Principalities. New case study: the Vorsi Family", në *Istros*, XVIII, Brăila: Istros editrice del museo di Brăila, 2012, f. 405-433, 411-412.

<sup>48</sup> L. Cotovanu, "Le diocèse de Dryinoupolis...", f. 237; Andrei Pippidi, "De Janina a Venise, fortune et fortune politique", në *Revue des études sud-est Européennes*, XL, 1-

Cigara dhe gruaja e tij Maria u zhvendosën në *San Giorgio dei Greci* në Venecia, ku ai kishte rol drejtues si *guardian grande*<sup>49</sup>.

Shqiptarët në Rumani të ardhur nga shtresa e tregtarëve filluan të luanin rolin e doganierëve, korrespondentëve tregtarë dhe të ktheheshin në pronarë në principatat rumune duke shtuar radhët e elitës së fisnikëve lokalë që kishin drejtimin e tyre<sup>50</sup>. Kështu, më 1628 Gjergj Leka nga Janina mbante postin e Dhomëtarit të Madh (Gran Ciamberlano) të Vllahisë.<sup>51</sup>

Po në të njëjtën periudhë, arrijnë nga Arbanasi i Răzgradit të Bullgarisë, Nikollë dhe Grigor Koçi, të cilët sipas Alexandru Sturdza\* ishin nga Elbasani.<sup>52</sup> Megjithatë, mendohet se familja Koçi mund ta ketë origjinën nga Gjirokastra<sup>53</sup>. Kjo për faktin se Gavrilin, djalin e Nikollës dhe vëllait të Vasilin, princi i Moldavisë i kishte dhënë pronësinë e një fshati të quajtur Hlincea në zonën e Lapushnës, ku gjendej dhe një manastir<sup>54</sup>. Nga mesi i shek. XVII, kur u konsoliduan si elitë dhe arritën edhe postet më të larta drejtuese me Vasil Lup Koçin (Vasile Lupu), princ i Moldavisë në periudhën 1634-1653 dhe djalin e tij Stefan në vitet 1659-1660<sup>55</sup>, Vasili ia dhuroi manastirin e Hlinceas manastirit të Drinos

4, vol. 40, Editions de L'Academie de la Republique Populaire Roumaine: 2002, f. 197-198.

<sup>49</sup> Nicolae Iorga, "Foia de zestre a unei domnite moldovene din 1587 și exilul venețian al familiei sale", në *Analele Academiei Române Analele Academiei Române. Memoriile Secțiunii Istorice*, s. III, vol. VI, Bukuresht:1927, ligjërata e mbajtur në Akademinë Rumune, më 18 qershor 1926.

<sup>50</sup> C. Luca, "Aspetti riguardanti i traffici...", f. 256-257.

<sup>51</sup> Lidia Cotovanu, "Un Boyard épirote de Moldavie: le grand chambellan Gheorghe Leca de Vezitsa (XVIIe siècle)", në *România în Europa medievală (între Orientul bizantin și Occidentul latin). Studii în onoarea Profesorului Victor Spinei*, ed. Dumitru Țeicu, Ionel Cîndea, Brăila: Istros editrice del museo di Brăila, 2008, f. 850, 852.

\* Ishte pasardhës i një familjeje fanariote në Rumani, që kishte lidhje martesore me familjen Gjika.

<sup>52</sup> L. Cotovanu, "Le diocèse de Dryinoupolis...", f. 240, 242-243 246-247; Alexandru Sturdza, *La terre et la race roumaine depuis leurs origines jusqu'à nos jours; ouvrage enrichi de 10 cartes et 186 figures*, Paris: L. Laveur, 1904, f. 354. Nikolla arriti postet më të larta në principatat rumune në vitet 1593-1611 dhe nga mesi i shek. XVI, djali i tij, Vasil Lup Koçi, u kurorëzua princ i Moldavisë.

<sup>53</sup> L. Cotovanu, "Le diocèse de Dryinoupolis...", f. 257.

<sup>54</sup> *Po aty*, f. 251-252.

<sup>55</sup> A. Sturdza, *La terre et la race roumaine...*, f. 354-361; Constantin Șerban, *Vasile Lupu, Domn al Moldovei (1634-1653)*, Editura Academiei Române, București: 1991.

në Gjirokastrë në vitet 1639-1650.<sup>56</sup> Manastiri ishte themeluar nga vëllezërit Zoto dhe Apostol Cigara (Tsigara), mbiemër me të cilin quhej dhe një lagje e Janinës, të cilët gjithashtu kishin ardhur nga Arbanasi i Răzgradit dhe kishin lidhje me familjen Koçi. Vasil Lup Koçi kishte marrëdhënie tregtare me Venecien me anë të tregtarit të dyllit nga Janina Stefan Babula (Babla) ose Stefano Baboulaio, që gjendej në oborrin e tij moldav dhe ishte korrespondenti i tij tregtar në Venecia ashtu si Leondar Giorma (Gionma) nga Pogoni.<sup>57</sup>

Prej njëres nga këto familje tregtarësh nga Labova e Gjirokastrës ose Zërnci i Përmetit e kishte prejardhjen edhe familja Gjika. Gjergj Gjika kishte ardhur në principatat rumune nga Velesi i Maqedonisë dhe u mbështet nga Vasil Lup Koçi, i cili e dërgoi si ambasador ose përfaqësues (kryeqehaja) të tij në Stamboll.<sup>58</sup> Paraardhësi i Dora D'Istrias mori drejtimin e Principatës së Moldavisë në vitet 1658-1660. Kështu, nga kjo familje doli një plejadë princash të principatave rumune, të cilët me anë të lidhjeve martesore me fanariotët, u siguruan pasardhësve edhe postin e kryedragomanit të Perandorisë Osmane.

Tregtari nga Poliçani Gjergj Duka, i cili tregtonte që në moshë të re me një tregtar veshjesh të bardha selanike, pati marrëdhënie të ngushta me Vasil Lup Koçin.<sup>59</sup> Ai i forcoi pozitat e tij pas martesës me Anastasian, vajzën e princit të Moldavisë Istriatie Dabija në periudhën 1661-1665, i cili kishte origjinë shqiptare nga e ëma, e bija e Thesarmbajtësit Palad.<sup>60</sup> Kjo i hapi rrugën atij që të bëhej ban dhe princ i Moldavisë në periudhat 1665-1666, 1668-1672 e 1678-1684 dhe princ e vojvodë i Vllahisë në vitet 1673-1678. Më pas, edhe djali i tij Kostandin Duka erdhi në fronin e Principatës së Moldavisë në periudhën 1693-1695 dhe 1700-1703.<sup>61</sup> Ai kishte një formim të lartë dhe u martua me Elenin, vajzën e Leondar Glykit (Leondari Glichi) me vendbanim në Janinë, i cili ishte i biri i Mihailit dhe vëllai i Nikollës, që i përkisnin një shtëpie të

<sup>56</sup> L. Cotovanu, "Le diocèse de Dryinoupolis...", f. 251.

<sup>57</sup> Lidia Cotovanu, "Autour des attaches épirotes du future prince de Moldavie Constantin Duka (XVIIe siècle)", në *Studia varia in honorem Professoris ştefan ştefănescu Octogenarii*, ed. Cristina Luca, Ionel Cădea, Bucureşti: Brăila, Editura academei române, muzeul Brăilei, editura Istros, 2009, f. 481.

<sup>58</sup> E. Gjika, *Shqiptarët në Rumani...*, f. 13-17.

<sup>59</sup> L. Cotovanu, "Autour des attaches épirotes...", f. 471.

<sup>60</sup> Antonmaria Del Chiaro, *Istoria delle moderne rivoluzioni della Valachia*, Venezia: Antonio Bortoli, 1718, f. 129-133, f. 472.

<sup>61</sup> L. Cotovanu, "Autour des attaches épirotes...", f. 293, f. 468-469, 471.

madhe tregtare, të cilët tregtonin dyllë në Venecia dhe me fitimet kryesisht nga tregtia e dyllit kishin hapur në vitin 1670 një shtypshkronjë librash në greqisht në Venecia, e cila ishte blerë më pas nga Orsino Albrizzi.<sup>62</sup> Kjo familje kishte kontakte me Nikolla Saron, i cili kishte ardhur në Venecia në vitin 1657 dhe kishte themeluar një shtypshkronjë tjetër, botimet e së cilës u shfaqën në vitet 1687-1707.<sup>63</sup> Në vitin 1693, ishte krijuar një kompani në ortaki për tregtinë e dyllit ndërmjet Pano Glykit në Venecia dhe Spiro Panos, i cili tregtonte nga kryeqyteti sakson i Transilvanisë Sibiu asokohe Hermannstadt dhe Foksani i Rumanisë.<sup>64</sup>

### **Konsullata veneciane e Durrësit dhe rrjeti i korrespondentëve**

Me hapjen e konsullatës veneciane të Durrësit më 1671, disa nga këto familje korrespondentësh tregtarë u vendosën në Durrës për të tregtuar me Venecien. Këtu ata gjetën një terren të favorshëm sepse nga çereku i fundit i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII, tregtia po e kthente Durrësin në një udhëkryq kombësish dhe komunitetesh tregtare, duke krijuar një ndërveprim të ngushtë ndërmjet tyre pas ngritjes së konsullatave të huaja.<sup>65</sup> Disa nga tregtarët ortodoksë mbajtën postin e konsujve, zëvendëskonsujve, dragomanëve ose funksione të tjera pranë konsullatës veneciane, franceze dhe holandeze në Durrës.

Në periudhën e sundimit të princit të Vllahisë Costantin Brâncoveanu (1688-1714), që përkon me rritjen e tregtisë së Durrësit me Venecien, mallrat e importit ai i siguronte me anë të tregtarëve nga

<sup>62</sup> *Po aty*, f. 465-471; Marino Zorzi, “Il libro greco dopo la caduta di Costantinopoli”, në *Scrittura e libro nel mondo greco-bizantino*, Venezia: CUEBC, 2012, f. 179-180.

<sup>63</sup> *Cenni sulla colonia greca orientale in Venezia e la sua laguna*, vol. I, parte II, Venezia: Stabilimento Antonelli, 1847, f. 96.

<sup>64</sup> C. Luca, “L’importazioni delle merci levantine nella Venezia del Seicento e del primo Settecento: la cera e i pellami provenienti dai Principati Romeni”, në *L’Italia e l’Europa Centro Orientale attraverso i secoli. Miscellanea di studi di storia politico-diplomatica, economica e dei rapporti culturali*, ed. Cristian Luca, Gianluca Masi, Andrea Piccardi, Venezia: Brăila, Istros editrice del Museo di Brăila, 2004, f. 333.

<sup>65</sup> Alvin Saraçi, “Roli i konsullatës veneciane të Durrësit në mbrojtje të interesave ekonomike të Venecies në fillim të shek. XVIII“, në *Studime historike*, 1-2, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 88-89.



Gjirokastra dhe Janina.<sup>66</sup> Ndër agjentët tregtarë ishin bankieri Niko Papa nga Pogoni dhe vëllezërit Mihail dhe Nikolla Karajani (Nicolò Caraggiani) nga Janina, për të cilët është folur më lart dhe Nikolla do të ketë një rol të rëndësishëm në tregtinë që kalonte nga Durrësi në Venecia.<sup>67</sup>

Mihail dhe Nikollë Karajani ishin nipat e tregtarit Pano Ieromnimon, që ishte kushëri i parë me tipografin Nikolla të familjes Glyki (Nicola Glichi) dhe e kishte futur Nikolla Karajanin në rrugën e tregtisë ashtu si dhe nipin tjetër Nikolla Pulimenon, i cili në fillim të shek. XVIII do të zgjidhej konsull i Holandës në Durrës.<sup>68</sup> Nikollë Karajani merrej kryesisht me tregtinë e dyllit dhe të lëkurëve me Venecien, por edhe me përhapjen e librave<sup>69</sup>. Në vitet e para të shek. XVIII, ai ishte krahu i djathtë i autoritetit venecian për tregtinë e Pesë të Urtëve, sepse ata i dhanë atij postin e njërit prej dy Krerëve të Tregut (Capi della Piazza) për tregtinë e Durrësit, misioni i të cilit ishte t'i informonte ata për ecurinë e tregtisë dhe t'i ndihmonte për përcaktimin e çmimeve etj.<sup>70</sup> Përtej raporteve familjare, interesat e vendeve që kishin konsullata në Durrës ishin në kontrast për shkak të konkurrencës tregtare, prandaj ato i ofronin poste të rëndësishme tregtarëve me përvojë, që kishin njohuri për vendin dhe kishin krijuar rrjete tregtare. Qëllimi i tyre ishte që nëpërmjet këtij ndërmjetësimi të zgjeronin shkëmbimet tregtare.

Në fillim të shek. XVIII, emrin e Niko Papës e gjejmë mes tregtarëve të Voskopojës. Mbetet për t'u parë se a ishte ky i njëjti tregtar bankier nga Pogoni për të cilin u fol më lart apo një tregtar homonim nga Voskopoja. Ai tregtonte lëkurë (saftjan) nëpërmjet portit të Durrësit dhe kishte si korrespondent në Venecia Jani Jeromnimonin (Giovanni di

---

<sup>66</sup> Lidia Cotovanu, Gheorghe Lazăr, "Un marchand banquier au service de Constantin Brancoveanu (1688-1714: l'epirote Nica Papa saraf", në *Thesaurismata*, 46, Istituto Ellenico di Studi Bizantini e Postbizantini, Venezia: 2016, f. 34-37.

<sup>67</sup> N. Iorga, *L'Histoire des roumains....*, f. 38.

<sup>68</sup> L. Cotovanu, "Autour des attaches épirotes...", f. 475-476.

<sup>69</sup> C. Luca, "L'importazioni delle merci...", f. 339.

<sup>70</sup> Asv, CSM, 2. S., b. 28, 24 shtator 1704; Cristian Luca, "The Dynamics of the Commercial Activity in the Ottoman Port of Durazzo during the Consulate of Zorzi (Giorgio) Cumano (1699 -1702)", në *Small is Beautiful? Interlopers and Smaller Trading Nations in the Pre-Industrial Period, Proceedings of the XVth Congress of Economic History Utrecht (Netherlands)* 2009, VSWG-Beihefte, 213, nën kujdesin e Markus A. Denzel, Jan de Vries, Philipp Robinson Rössner, Stuttgart: F. Steiner, 2011, f. 183.

Gerolamo).<sup>71</sup> Ka shumë gjasa që ai të jetë tregtari nga Pogoni, sepse mes tyre ekzistonte një lidhje familjare e dyfishtë. Djali i tij Panajoti ishte martuar me të bijën e Jani Jeromnimonit nga Janina, kurse vajza e tij me Nikolla Glykin, nipin e tipografit.<sup>72</sup>

Në fund të shek. XVII, falë marrëdhënieve tregtare me Venecien, disa tregtarë kryesisht nga Janina, Arta dhe Voskopoja që frekuentonin edhe qendra të tjera ekonomike ballkanike, u kthyen në Venecia në tregtarë porositës (*commissionari*), të cilët me anë të ortakëve dhe agjentëve të tyre tregtarë i porositnin mallrat nga Shqipëria dhe vende të tjera të Ballkanit.<sup>73</sup> Ky ishte një hap cilësor, *së pari*, sepse kështu ata kishin rol ndërmjetësues për venecianët me hapësirën ndërballkanike. *Së dyti*, lëvizja nga porti i Durrësit, ku konvergonte tregtia ballkanike, i dha mundësi atyre që të përfaqësonin tregtarë të tjerë dhe të drejtonin fluksin e mallrave drejt Venecies, duke promovuar politikën tregtare veneciane në Shqipëri. Në Venecia, ata i forcuan pozitat si tregtarë të mëdhenj, sepse në duart e tyre kalonte një pjesë e madhe e tregtisë pa pasur nevojë që të lëviznin.

Hapja e Venecies ndaj tregtarëve të huaj, të cilëve iu dhanë disa të drejta në mënyrë që ata të kontribuonin për ripërtëritjen e tregtisë, erdhi si rrjedhojë e dekadencës relative në ekonominë veneciane. Në fakt, shtetësia veneciane ishte e lidhur me disa të drejta për ushtrimin e tregtisë, dhe jepej në dy mënyra: 1. *de intus* dhe 2. *de intus e de fora*. E para i jepte mundësi tregtarit të huaj që ta ushtronte tregtinë brenda territorit urban të Venecies, ndërsa e dyta i jepte të drejtën që të tregtonte me të njëjtat të drejta si tregtarët venecianë edhe përtej detit.<sup>74</sup>

<sup>71</sup> *Asv, CSM*, 1 S, b. 661, policë-ngarkesë e vitit 1700; *Letra të konsujve venedikas të Durrësit ...*, dok. nr. 8, 1700, f. 41-42.

<sup>72</sup> L. Cotovanu, "Gestionari epirofi...", f. 153-154.

<sup>73</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVIII*, dok. nr. 228, 8 shkurt 1699, f. 476-478; Cristian Luca, "Greek and Aromanian merchants, protagonists of the trade relations between Transylvania, Wallachia, Moldavia and the Northern Italian Peninsula (second half of the 17<sup>th</sup>-first half of the 18<sup>th</sup> Century)", në *Transylvanian Review*, vol. XIX, supplement No. 5:4, Romania: 2010, f. 313, 318-319. Tregtarët porositës ishin: Michele Perulli, Antonio Margana, Andrea Kotoni, Jani Jeromnimon ose i Jeronimit (Giovanni di Gerolamo o di Geronimo), Nikollë Karajani (Nicolò Caragiani-Nikolaos Caraiannis), Gjergj Peio (Giorgio Peio), Gjergj Stamateli (Giorgio Stamatello), Stefan Cigara (Stefano Tsigara), Diamant Bufesi, Pano Strati, Gjon Papa dhe Piero Ferro.

<sup>74</sup> Mario Caravale, "Le istituzioni della Repubblica", në *Storia di Venezia. Dalle origini alla caduta della Serenissima: La formazione dello stato patrizio*, vol. 3, nën kujdesin

Pikërisht, në hapat e parë të zgjerimit të tregtisë me Shqipërinë dhe hapjes së konsullatës veneciane të Durrësit, Venecia u bazua mbi tregtarët ortodoksë, të cilët patën një rol thelbësor në periudhën kur Venecia u përfshi në luftën e parë të Moresë dhe paqen e Karlovicit (Sremski Karlovcit) më 1699 me rënien në dekadencë të Raguzës deri në gjysmën e parë të shek. XVIII.

### *S u m m a r y*

#### THE BROKERING ROLE OF THE MERCHANTS FROM THE SOUTHERN AND LOWER ALBANIA AS AN IMPORTANT FACTOR FOR THE VENETIAN TRADE

The positive impact of trade was reflected in the economic development, demographics and urbanization of the Albanian towns. Brokering was of particular importance for the Venetian trade. A primary role for its expansion was played by the merchants of Orthodox faith from Janina, Arta, Pogoni, Voskopoja, etc, who settled in Venice at the Greek fraternity “Scuola dei Greci” by the end of the XV century and the middle of the XVI century. At the same period, they set up various settlements in Bulgaria including Arvanitochori of Tarnovo and Arbanasi of Razgrad, from where they emigrated to the Romanian Principalities and some of them such as Vasil Lup and Stefan Koçi, Gjergj and Gregor I Gjika, Dora d’Istria’s forefathers, Gjergj and Konstantin Duka etc reached the highest positions and had trade relations with Venice by means of their brokers. Even the Albanian dragomans Bartolomeo Bruti and his nephews who belonged to the Boriçi (Borisi) family, had a great weight in the relations of Venice with Istanbul and the Romanian Principalities. After the opening of the Venetian consulate and other foreign consulates in Durrës in the first quarter of the XVII century, where converged inter-Balkan trade, it became a crossroads of merchants and wares. Some of them were employed in the consulates and then moved to Venice and traded as farwarders.

